



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 524/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, paraqitur kundër Shkumbin Kabashi, për shkak të sulmit fizik në vendvotim, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën ankesë pretendohet se më datë 03.11.2013 diku rreth orës 09:50 në Qendrën e Votimit në fshatin Opertushë, Shkumbin Kabashi i biri i Rrahmanit, i cili ka tentuar që të hyjë me dhunë në vendvotim, por për këtë është munduar që ta ndalë komisionari i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) Besim Bytyqi, i cili nga i njëjti është goditur me lllaptop në kokë. Sipas parashtruesit të ankesës Shkumbin Kabashi duke sulmuar fizikisht komisionerin Betim Bytyqin ka ndërmarrë veprimin i cili përbënte figurën e veprës penale nga neni 217 par.2 të Kodit Penal të Kosovës. Pretenduesi i ankesës potencon se i dyshuari është mbështetës i subjektit politik të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), gjë që paraqet shkelje të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes dhe rasti është raportuar në polici dhe pranë prokurorit kujdestar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se në Qendrën e Votimit në fshatin Opertushë ka pasur sulm fizik gjatë procesit zgjedhor, nuk qëndrojnë sepse nuk kemi asnjë raport policor dhe as nga prokuroria për rastin në fjalë, andaj PZAP-i konstatoi se pretendimet e subjektit politik LVV, kanë mungesë të provave, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për rastin e pretenduar. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 524/2013 më datën 07.11.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.